



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.238/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi Valon Brahimi, kandidat nga radhët e subjektit Politik PDK, me adresë në Sheshi “Adem Jashari”, Mitrovica e Jugut parashtruar kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), në Mitrovicë të Jugut, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.238/2025 datë 17.10.2025, parashtruar nga parashtruesi i ankesës Valon Brahimi, kandidat nga radhët e subjektit Politik PDK, me adresë në Sheshi “Adem Jashari”, Mitrovica e Jugut, parashtruar kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), në Mitrovicë të Jugut, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 17.10.2025, PZAP-i, permes postes ka pranuar ankesën, e parashtruar nga Valon Brahimi, kandidat nga radhët e subjektit Politik PDK, e me adresë në Sheshi “Adem Jashari”, Mitrovica e Jugut, në të cilën pretendohet se me datë 14.10.2025, në orën 10:30, ka pranuar një informacion të dokumentuar përmes fletëvotimit me numër 1110/05, nga komisionerët të cilët e kanë hasur në QNR në Mitrovicë, i cili dokument sipas parashtruesit të ankesës, dëshmon që kutia e fletëvotimit në qendrën e votimit të lartëcekur nuk posedon numrat e shiritave për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit, për çka ngrit dyshimin e manipulimit në procesin zgjedhor, respektivisht keqpërdorimit në kutinë e votimit sa i përket votave. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur një kopje fizike të formularit.

Në përgjigjen në ankesë të datës 18.10.2025, Komisioni Qendror Zgjedhor kanë deklaruar se në kuptim të neneve 8 dhe 15 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, ndër detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit përfshihet edhe mbyllja e kutisë së votimit me shirita sigurie të komunës përkatëse, ku Kryesuesi i KVV-së obligohet të shënojë numrat serik të shiritave mbyllës në Formularin e Rezultateve të Subjekteve (FRS).

Gjithashtu, në përputhje me nenin 17, paragrafi 4 të së njëjtës Rregullore, pas përfundimit të procesit të numërimit dhe evidentimit të të gjitha fletëvotimeve, si dhe plotësimit të formularëve përkatës, paketimi i materialeve zgjedhore dhe mbyllja e kutive kryhen në pajtim me procedurat e miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Lidhur me vendvotimin Nr.1110/05 sa i përket ankesës për këtë vendvotim që ka të bëjë me mungesën e nënshkrimeve në formularin për Kryetar Komune, numri i shiritave është në fletën origjinale të formularit, mirëpo KVV, nuk i ka bartë në fletën tjetër, shiritat mbyllës të kutisë janë në përputhje me shiritat e formularit të pranimit në QKN në ditën e zgjedhjeve

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës, përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe provave të dorëzuara nga ky institucion, Paneli vlerësoi pretendimet ankimore të subjektit politik PDK, lidhur me kutinë e votimit në Qendrën e Votimit në Mitrovicën e Jugut me numër 1110/05.

Subjekti ankimues pretendon se kjo kuti votimi nuk posedon numrat e shiritave për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit. Megjithatë, Paneli vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara, për faktin se parashtrësi i ankesës nuk ka ofruar prova konkrete për të vërtetuar këto pohime, edhe pse i është referuar parregullsive të supozuara në Qendrën e Komunale të Numerimit (QKN).

Nga administrimi i provave të pranuar nga PZAP, të cilat janë paraqitur, edhe në përgjigjen e KQZ-së, konstatohet se numri i shiritave është në fletën origjinale të formularit, mirëpo KVV, nuk i ka bartë në fletën tjetër, shiritat mbyllës të kutisë janë në përputhje me shiritat e formularit të pranimit në QKN, në ditën e zgjedhjeve, dhe se numrat e shiritave për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit numer 1110/05 janë MI3084, MI3083, MI3082, MI3081 si dhe numri i shiritit për mbylljen e vrimës së kutisë së votimit është MI3085.

Bazuar në arsyet e lartëpërmendura, dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decrive thuhet se : *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"*, ndërsa në nenin 13 par. 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decrive thuhet se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Valon Brahimi, kandidat nga radhët e subjektit Politik PDK, është e pabazuar pasi që pretendimi për mungesën e numrit të shiritave në mbylljen e kapakut të kutisë së votimit, në QKN në Mitrovicën e Jugut, nuk qendron, për arsye se shiritat mbyllës të kutisë janë në përputhje me shiritat e formularit të pranimit në QKN, në ditën e zgjedhjeve, dhe se numrat e shiritave për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit numer 1110/05 janë MI3084, MI3083, MI3082, MI3081 si dhe numri i shiritit për mbylljen e vrimës së kutisë së votimit është MI3085, andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decrive thuhet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja*

mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLAnr.238/2025 më datën 20.10.2025

Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.